



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK**

(Adresa, Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës e-mail: info@vaudejes.gov.al)

Nr. 3342 Prot.

Vau Dejës me 16/06/2025

PROJEKT VENDIM

PËR:

“Miratimin e mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës Znj. Edona Ndue Molla”

Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 49, pika 1,2,3, neni 54, germa j, si dhe në vendimin nr.1031 datë 09.05.2025 i KQZ, komisioni i mandateve i Këshillit Bashkiak Vau Dejës propozon të:

VENDOSI:

1. Miratimin e mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, Znj. **Edona Ndue Molla** propozuar nga subjekti politik, Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, si pasojë e vakancës së krijuar nga Znj. **Kristjana Gjovalin Kovaçi**.

KRYETARI KËSHILLIT

Ervis Shimaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK

(Adresa, Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës e-mail: info@vaudejes.gov.al)

RELACION

Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, si pasojë e vakances së krijuar nga ish anëtarja e Këshillit Bashkiak Vau Dejës, Znj. Kristjana Kovaçi, (neni 49 pika 4 germa e), dhe në bazë të nenit 49 pika 1,2,3 si dhe në vendimin nr.1031 datë 09.05.2025 të KQZ Tiranë për plotesimin e vakances në Këshillin Bashkiak Vau Dejës, me kandidatin nga lista shumëëmërore e Partisë Socialdemokrate e Shqipërisë Znj.Edona Ndue Molla, i propozojmë Këshillit Bashkiak Vau Dejës që në mbledhjen e rradhës së muajit Qershor 2025, të miratojë mandatin e anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës Znj.Edona Ndue Molla.

Kryetari Këshillit

Ervis Shimaj





Om. 3160 Prot
Dt: 05.06.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më 02/06/2025

Nr. 5024

Lënda: Njoftim për vazhdimin e procedurave për dhënien e mandatit

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Vau - Dejës

Rruga "Qafa e Gurit", Vau-Dejës

Partisë Socialdemokrate

Rruga "Skënderbej", Blloku i Ambasadave, Tiranë

Zj. Edona Ndue Molla

Vau-Dejës

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancën publike të datës 09.05.2025, mori në shqyrtim projekt-vendimin "Për plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Vau-Dejës, pas verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidatit, vendosi "Plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Vau-Dejës, me kandidatin nga lista shumemërore e "Partisë Socialdemokrate" zj. Edona Ndue Molla.

Bashkëlidhur do të gjeni vendimin nr. 1031, datë 09.05.2025.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Sekretar i Përgjithshëm

(Në mungesë dhe me urdhër)

Majlinda CELMETA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 9.5.2025

Nr: 1031

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË VAU- DEJËS, ME
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E "PARTISË SOCIALDEMOKRATE", ZJ.
EDONA NDUE MOLLA

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 1681 prot., datë 14.04.2025, Këshilli i Bashkisë Vau Dejës, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zj. Kristana Gjovalin Kovaçi, propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialdemokrate".

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e "Partisë Socialdemokrate", për Këshillin e Bashkisë Vau Dejës, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 14, zj. Edona Ndue Molla.

Me shkresën nr. 3094, prot., datë 17.4.2025, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Vau-Dejës zj. Edona Ndue Molla, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Data: 9.5.2025 Nr: 1031
Ora: 12:00



"Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Vau -
Dejës, me kandidatin nga lista shumemërore e "Partisë
Socialdemokrate" zj. Edona Ndue Molla"

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit Partia Socialdemokrate, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër SHK-PSD-11903_1_2 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të zj. Edona Ndue Molla, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja "b" dhe pika 3, shkronja "c", të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit me shkresën nr. 3471 prot., datë 29.4.2025, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile, dhe me shkresën nr.3470 prot., datë 29.4.2025, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, për zj. Edona Ndue Molla.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesë sonë për verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar zj. Edona Ndue Molla.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 6670/1 prot., datë 2.5.2025, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për zj. Edona Ndue Molla, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Edona Ndue Molla, në Këshillin e Bashkisë Vau-Dejës, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreun V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"

V E N D O S:

1. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Vau-Dejës, me kandidatin nga lista shumemërore e "Partisë Socialdemokrate", zj. Edona Ndue Molla.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.



Data: 9.5.2025 Nr: 1031
Ora: 12:00



Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve



"Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Vau-Dejës, me kandidatin nga lista shumemërore e "Partisë Socialdemokrate" zj. Edona Ndue Molla"